

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestimi i Vlora Hysenit - Shërbimet sekrete në shërbim të krimit të organizuar/ PD: Rama të japë llogari për situatën e rëndë në SHISH
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918817/sherbimet-sekrete-ne-sherbim-te-krimit-te-organizuar-pd-kerkon-debat-me-ramen-per-situaten-e-rende-ne-shish/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 08:08:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 07:50:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dbef851bba684540d7b2c2baea60bd0c07eec2e90db4b5fb3cccef51b28e4ffe
TEKSTI	9488d1c3bf53978194bf9a418d69f06e3116a5f06ea010cf9b38a16dbf72e866
PAMJA	92a7e51904a614ed6a72c8dfc6047d2f506dafae4460ad26722fba2f97cc66c9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0d7d22b2dd3c9affe0e54270ac7f9fac7a53001b1354e9e4d7c1edae7d9bc500
E MËPARSHMJA	ee2b8331e3569277140ff694c5d3f59d37335ef83efa70b2f8cd693d0a4ba137
RRËNJA MERKLE	9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0d7d22b2dd3c9affe0e54270ac7f9fac7a53001b1354e9e4d7c1edae7d9bc500>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**LAJMI I FUNDIT****LIVE - Seancë plenare dhe protestë, policia 'blindon' parlamentin! Flet kreu i PD-së, Sali Berisha****më të lexuarat**VIDEO- 'Janë 3 orë përgjime' / Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Protesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënMashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartëVIDEO- 'Hajde të tregoj unë ty' /
Përplasja me Ramën në avion, i riu: Më
kapi për qafe dhe më tha 'të zhduk'Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë

'S'ka normalitet për situatën ku

**Shërbimet sekrete në shërbim të krimit të
organizuar/ PD: Rama të japë llogari për
situatën e rëndë në SHISH**

09:50, 24/09/2026

ZMADHO TEKSTINPD kërkon ndryshimin e Rendit të Ditës në seancën e sotme parlamentare. PD
kërkon heqjen e 2 interpelancave nga rendi i ditës dhe shtimin e një pike.Kontroll dhe debat parlamentar me Kryeministrin Edi Rama lidhur me situatën e
rëndë në Shërbimin Informativ Shtetëror.*"Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të qëndrojë indiferent dhe ta trajtojë këtë çështje
si një veprimtari e zakonshme hetimore e Prokurorisë së Posaçme kundër
Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke vijuar normalisht veprimtarinë e tij
parlamentare. Kur shërbimet sekrete të një shteti vihen në shërbim të krimit të
organizuar, atëherë bie vetë koncepti i shtetit dhe sigurisë kombëtare të tij, që
duhet të mbrohet pikërisht nga këto shërbime.**Në përputhje me rolin dhe funksionet e tij, Kuvendi i Shqipërisë duhet të kërkojë
urgjentisht nga kryeministri Edi Rama që të japë informacione dhe shpjegime mbi
përzgjedhjen e shtetases Vlora Hyseni në këtë detyrë, duke pasur parasysh
rekodet e saj problematike në Republikën e Kosovës, si dhe veprimtarinë e saj në
drejtimin e Shërbimit Informativ Shtetëror, të debatohet mbi përgjegjësitë
institucionale, si dhe të vlerësojë marrjen e masave të nevojshme për të
parandaluar fenomene të tilla në të ardhmen.**Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në cilësinë e kryetarit të Grupit
Parlamentar të Partisë Demokratike, në mbështetje të nenit 31, pika 2, të
Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë ndryshimin e rendit të ditës të
seancës plenare të datës 24.09.2026, ora 10:00, si më poshtë vijon:**Heqjen e pikave: "Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, z. Sofjan Jaupaj,
kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
Interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit, zni. Mirela Kumbaro, kërkuar nga*

interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit, z. Sofian Jaupaj, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.”.

Shtimin e një pike “Kontroll dhe debat parlamentar me Kryeministrin Edi Rama lidhur me situatën e rëndë në Shërbimin Informativ Shtetëror” thuhet në kërkesën e firmosur nga kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi.


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 4292 Prot. Tiranë, më 24.09.2026

Lënda: Kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Me Urdhrin Nr. 56, datë 22.09.2026, keni urdhëruar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 24.09.2026, ora 10:00, me rend dite, ndër të tjera, si vijon: “3. Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, z. Sofian Jaupaj, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. 4. Interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit, z. Mirela Kumbaro, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.”.

Megjithëse, të dy çështjet, si ajo e 102 kontejnerëve me 2.816 tonë mbetje të rezikshme në qytetin e Durrësit, ashtu edhe problematikat e arsimit parauniversitar në përgjithësi dhe në qytetin e Sarandës në veçanti, për të cilat është kërkuar interpelancë urgjente, përbëjnë çështje me interes të lartë publik, zhvillimet e dy ditëve të fundit të lidhura me Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), Vlora Hyseni, kërkojnë detyrimisht që të marrin vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet kontrollit dhe debatit parlamentar.

Konkretisht, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka njoftuar zyrtarisht ditën e marte, datë 22.09.2026, se ndaj Drejtorit të SHISH, Vlora Hyseni janë vendosur masat e sigurimit personal “Arrest në shtëpi” dhe “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, pasi nga hetimet e kryera në kuadër të procedimit penal nr. 20/1, të vitit 2025, ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se kjo shtetase ka konsumuar veprat penale të “Perkrahjes së autorit të krimit” dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga nenet 302 dhe 295/a të Kodit Penal.

Nëpërmjet kësaj veprimtarie të paligjshme, shtetasja Vlora Hyseni ka dëmtuar rëndë besimin e publikut tek institucionet shtetërore, ashtu si edhe besimin e partnerëve ndërkombëtare tek shteti shqiptar, ka cenuar sigurinë kombëtare, si dhe sigurinë e aleatëve të NATO-s. Është rast unik dhe i paprecedent në historinë e Shqipërisë që Drejtori i SHISH vendoset në dy masa sigurimi personal, pasi ekzistojnë të dhëna, indicie dhe prova bindëse se ka ndihmuar Ergys Agasin, një person në kërkim për kryerjen e veprave penale shumë të rënda, përfshirë grup të strukturuar kriminal.

1

korruption aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe heqje të paligjshme të lirisë, si dhe ka furnizuar këtë person me informacione të klasifikuara “sekret shtetëror”.

Në këto kushte, Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të qëndrojë indiferent dhe ta trajtojë këtë çështje si një veprimtarie të zakonshme hetimore e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke vijuar normalisht veprimtarinë e tij parlamentare. Kur shërbimet sekrete të një shteti vihen në shërbim të krimit të organizuar, atëherë bie vetë koncepti i shtetit dhe sigurisë kombëtare të tij, që duhet të mbrohet pikërisht nga këto shërbime.

Në përputhje me rolin dhe funksionet e tij, Kuvendi i Shqipërisë duhet të kërkojë urgjentisht nga kryeministri Edi Rama që të japë informacione dhe shpjegime mbi për zgjedhjen e shtetasës Vlora Hyseni në këtë detyrë, duke pasur parasysh rekodet e saj problematike në Republikën e Kosovës, si dhe veprimtarinë e saj në drejtimin e Shërbimit Informativ Shtetëror, të debatotojë mbi përgjegjësitë institucionale, si dhe të vlerësojë marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar fenomene të tilla në të ardhmen.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në mbështetje të nenit 31, pika 2, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë ndryshimin e rendit të ditës të seancës plenare të datës 24.09.2026, ora 10:00, si më poshtë vijon:

(i) Heqjen e pikave: “3. Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, z. Sofian Jaupaj, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. 4. Interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit, z. Mirela Kumbaro, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.”.

(ii) Shtimin e një pike “Kontroll dhe debat parlamentar me Kryeministrin Edi Rama lidhur me situatën e rëndë në Shërbimin Informativ Shtetëror”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
KRYETARI
Gazment BARDHI



2

ndodhemi”, Këlliçi: Të gjithë e kanë pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama jo!

‘Garancia e plotë’ e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

‘Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar’, Blushi: ‘KAYO’ e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

Nata e 6 në shesh kundër dënimit të ish-kryerëve të UÇK-së/ Protestës i bashkohet edhe Përparim Rama

Lexo edhe:



Skandali i madh në SHISH/ Kalaja: SPAK po publikon vetëm mesazhet erotike, po mundohet të fshehtë të vërtetën



Protesta para Kuvendit/ Narkopolicia arreston 4 protestues paqësorë, mes tyre Dritan Goxhaj



'Krejt radarët i mbyll për ty'/ Si ra siguria në dorën e krimin, ja SMS-të me numra rusë të Vlora Hysenit

TË NGJASHME



Rama rrethon Kuvendin me gardhe metalike, masa të forta sigurie para protestës



'Në vend që të prekim realitetin, manipulojmë', eksperti: Qeveria la jashtë PISA-s shkollat rurale



Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike



Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026



'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin



Kuvendi mbledhet sot në seancë plenare, dy interpelanca dhe dy projektligje në rendin e ditës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net